



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1247/6 prot.

Datë 04.06.2024

V E N D I M
Nr.614/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.06.2024 me,

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Montal” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-01902-04-18-2024, me objekt: “Furnizim Vendorsje pajisje Mjekësore Kolonë Endoskopie” për QSRT “Shefqet Ndroqi”, me fond limit 9,925,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës Shefqet Ndroqi.
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës Shefqet Ndroqi
Rruga “Shefqet Ndroqi” Sauk, Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Montal” SHPK me NIPT J62009007F dhe adresë: Rruga Dervish Hima-3 kullat K.3 Ap9/2, Tiranë.
- Subjekte të interesuar:** Operatori ekonomik “Greemed” SHPK me NIPT K91329017I dhe adresë: Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Ramazan Demneri, Ndertesa Nr.1, Hyrja 13, Kodi Postar 1022, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.04.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-01902-04-18-2024, me objekt: “Furnizim Vendorsje pajisje Mjekësore Kolonë Endoskopie” për QSRT “Shefqet Ndroqi”, me fond limit 9,925,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës Shefqet Ndroqi.

II.2. Në datën 30.04.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 07.05.2024, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“GREEMED” SHPK	6.995.000 lekë	Kualifikuar
“Medfau” SHPK	8.600.000 lekë	Kualifikuar
“Montal” SHPK	7.748.000 lekë	Kualifikuar

II.4. Në datën 14.05.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 20.05.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4100, si dhe nr. protokollit 1247/2024 datë 20.05.2024 e operatorit ekonomik “MONTAL” SHPK lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “GREEMED” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1247/2 prot, datë 21.05.2024.

II.9. Në datën 31.05.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1247/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr.94 prot., datë 29.03.2024, me objekt, “Dërgim dokumentacioni”, bashkëngjitur së cilës autoriteti kontraktor ka përcjellë informacion lidhur me procedurën e prokurimit, si dhe vendimin e komisionit të shqyrtimit të ankesave për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Montal” SHPK. Referuar vendimit të KSHA nr.312/33 prot., datë 22.05.2024, rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur të pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

II.10 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor, nuk rezulton që operatori ekonomik “Greemed” SHPK, si subjekt i interesuar, të ketë paraqitur Formularin e paraqitjes së argumenteve, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Montal ” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e

ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Greemed” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me shkresën nr.94 prot., datë 29.03.2024, me objekt,“Dërgim dokumentacioni”, protokolluar me tonën me nr. 1247/3 prot, datë 31.05.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimit i KSHA nr.312/33 prot., datë 22.05.2024. referuar këtij të fundit, rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur të pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues si më poshtë:

[...] Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, shqyrtoi dhe vlerësoi ankesën e dorëzuar nga operatori ekonomik Montal shpk dhe dokumentacionin e paraqitur nga operatori konkurues Greemed shpk.

Në përfundim të shqyrtimit KSHA vendosi të pranojë ankesën e operatorit ekonomik Montal shpk”.

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës nr. 312/35 prot., datë 24.05.2024, protokolluar me tonën me nr.1247/3 prot., datë 31.05.2024, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës Shefqet Ndroqi, e ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi. Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Montal” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, pika 1 dhe 3 e nenit 115 dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Montal” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-01902-04-18-2024, me objekt: “Furnizim Vendorsje pajisje Mjekësore Kolonë Endoskopie” për QSRT “Shefqet Ndroqi”, me fond limit 9,925,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës Shefqet Ndroqi .
 2. Komisioni i vlerësimit të ofertave të bëjë rivlerësim të procedurës së prokurimit, në zbatim të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Montal” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

